

Fletënjoftim

Për kurs integrimi

për shtetase- dhe shtetas të huaj që jetojnë veqse kohë te gjatë në Gjermani si dhe qytetaret- dhe qytetarët e bashkësis Evropiane.

E dashura qytetare, i dashuri qytetar,

Nëse ju si nënshtetase- dhe nënshtetas i huaj jetoni veqse një kohë të gjatë ne Gjermani, apo në qofte se jeni qytetare-, repsektivisht qytetar i bashkësis Evropiane, ju mundeni te parashtroni pranë entit federativ kerkesë për të ju lejuar Ju pjesëmarrja në një kurs integrimi. Kjo është e mundshme edhe nëse ju sipas ligjit për lejeqendrim ne menyre ligjore nuk gëzoni të drejtën për pjesëmarrje, apo nuk e posedoni më një të drejtë të tillë.

Fëmijët, të rinjët dhe të rriturit të cilet ende vizitojnë shkollën, nuk mund të marrin pjesë.

Çka don të thotë kurs integrimi?

Kursi për integrim përbëhet nga një kurs i gjuhës me deri 600 orë mësimi dhe nga një kurs orientimi me 30 orë mësimi.

Në kursin e gjuhës Ju përvetsoni pasuri leksikore, e cila ju nevojitet çdo ditë të flisni dhe të shkruani. Sa i përket kesaj janë kontaktet me zyrat e ndryshme, bisedat me fqinjët dhe kolegët e punës, shkruarja e letrave dhe plotësimi i formularëve. Kursi i gjuhës është i ndarë në pjesë të ndryshme me nga 100 orë. Se në cilën pjesë ju do të filloni kursin, vendoset nga testi i cili bëhet para fillimit të kursit.

Kursi orientus ju informon Ju mbi jetën ne shoqërin gjermane si dhe ju jep juve informata mbi rregullat e drejtësis, kulturen si dhe historin e vendit.

Në fund të kursit për integrim bëhet një provim përfundimtar, i cili përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë të provimit mundeni ju të merrni çertifikaten për gjuhen Gjermane, një çertifikat gjuhe që pranohet, nëse kaloni provimin e gjuhes në mënyrë gojore dhe me shkrim. Në pjesën e dytë të provimit bëhet kontrollimi se çka keni mësuar në kursin orientus. Ju së fundi do të pranoni nga organizuesi i kursit një vërtetim përkitazi rezultatit të provimit përfundimtar.

Pëveq kësaj ju keni gjithashtu të drejtën të pranoni një vërtetim sa i përket pjesëmarrjes së rregullt ne kursin për integrim. Organizuesi i kursit e ka për detyrë të ju lëshoj Ju një vërtetim për secilën pjesë te mbaruar kursit.

Përparsit me pjesëmarrjen në kursin për integrim

Shtetaset- dhe shtetasit e huaj që kanë prejardhjen nga një shtetë i cili nuk është në bashkësin Evropiane, duhet ti përmbushin disa kushte paraprake, nëse dëshirojnë të marrin një lejeqendrim të pakufizueshëm për Gjermani. Sa i përket kushteve paraprake ju nevojiten njohuri të mjaftushme mbi gjuhën gjermane si dhe njohuri themelore te drejtësis, rregullit shoqëror dhe rrethanave jetësore në Gjermani.

Me mbarim të suksesshëm të kursit për intergim është përmbush një nga këto kushtet paraprake.

Përveq kësaj, sipas rastit e keni mundësin të mirrni më herët shtetësinë.

Paraqitja në kursin për integrim

Ju lutemi plotësoni tërësisht- dhe në mënyrë të lexueshme kërkesen për lejë pjesëmarrjeje në kurs. Ju mund ti drejtoheni edhe ndonjë organizuesi kursit në rrethin tuaj, i cili mund të ju ndihmoj përgjat parashtrimit të kërkesës.

Formularët për kërkesë gjinden tek zyra për nënshtetas të huaj, tek orgasnizuesit e kursit si dhe në faqën e internetit të entit federativ për emigration dhe refugjatë (www.bamf.de). Kërkesën e Juaj mund të ja dërgoni zyres regjionale të entit federativ, e cila është kompetente për regjionin e Juaj.

Nëse ju lejohet Ju të mirrni pjesë në kursin për integrim, do të pranoni nga enti federativ një vërtetim me shkrimë. Njëkohësisht do të pranoni një listë me organizuesit e kursit, të cilët organizojnë kurse për integrim në regjionin e Juaj.

Në këtë vërtetim është e shenuar në rreshtin „E drejta për pjesëmarrje është e vleshme deri...“ një datë deri me të cilën Ju mund të filloni kursin për integrim.

Për këtë arsye, ju lutemi sa më shpejtë që është e mundëshme të lajmëroheni tek një organizues i kursit për integrim, si dhe tregojeni atje vërtetimin me shkrim mbi të drejtën për pjesëmarrje!

Shpenzimet e kursit për integrim

Për pjesëmarrje në kursin e intergimit Ju duhet ti paguani organizuesit të kursit një shumë me vlerë prej 1 Euro për secilen orë mësimi. Shuma duhet të paguhet para fillimit te kursit për çdo pjesë të kursit prej 100 orë mësimi dhe për kursin orientus.

Nëse ju nuk keni të ardhura personale, shpenzimet kontribuse duhet ti paguaj ai person, i cili është i detyruar të kujdeset për shpenzimet e juaja.

Pjesëmarrësit të lejuar për kursë të cilët pranojnë parat e papunësis II ose pranojnë ndihmë për shpenzimet jetësore (ndihmë sociale), mundën të lirohen nga shpenzimet kontribuse.

Kjo vlen gjithashtu edhe për personat të cilët pranojnë te njejtat pagesa e janë të obliguar të kujdesen për mirëmbajtjen e pjesëmarrëses apo pjesëmarrsit.

Kërkesen për lirim nga shpenzimet kontribuse Ju duhet ta parashtroni me shkrim pranë zyrës regjionale te entit federativ e cila është kompetente për Ju (shifni listen e adresave). Ju lutemi ja bashkangjitni kërkesës edhe dëshmin mbi arsyet e liritimit (Kopje e vërtetimit perkatës). Ju lutemi parashtroni kërkesen më se voni deri atëherë, kur të lajmëroheni tek organizuesi i kursit. Formularët për parshtrimin e kërkesës mund ti pranoni si atje, njashtu edhe tek zyra për nënshtetas të huaj e cila është kompetente për Ju.

Pjesëmarrësit te lejuar për kursë të cilët janë të liruar nga shpenzimet kontribuse, duhet menjëherë ta lajmërojnë entin federativ, nëse nuk marrin më parat e papunësis II ose nuk marrin më ndihmë për shpenzimet jetësore (ndihmë sociale). Shpenzimet e provimit (testit) përfundimtar duhet ti paguani vetvetiu. Kërkesen me shkrim për lirim in e juaj nga këto shpenzime Ju në këtë rast mund ta bëni gjithashtu tek zyra regjionale e entit federativ, e cila është kompetente për Ju. Formularin për parashtrimin e kërkeses mund ta mirrni tek organizuesi i kursit apo përmes faqes së internetit të entit federativ për emigracion dhe refugjatë (www.bamf.de).